



100 Vjet Pavarësi

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.2113, datë 28.06.2012**

**Për**

**“Miratimin e dokumentit për Këshillim Publik: “Mbi propozimin për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 28.06.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Miratimin e dokumentit për Këshillim Publik: “Mbi propozimin për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike””,**

## BAZA LIGJORE:

1. Neni 78, 86, 110 si dhe shkronja c) dhe ç) e nenit 119 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr.9918*);
2. Pikat 12 dhe 17 të nenit 21 dhe shkronja f) pika 3 e nenit 23 e “Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendëshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
3. Udhëzuesi “Për procedurat e Këshillimit Publik” miratuar me Vendim nr. 1183, datë 10.03.2010, të Këshillit Drejtues të AKEP;

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Projekt Vendimi;
- Relacioni shoqërues i Projekt Vendimit;
- Dokumenti për Këshillim Publik.
- si dhe,  
duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

## V Ë R E N:

1. AKEP, në zbatim të detyrimit ligjor të pikës 2 të nenit 119 të ligjit nr. 9918 me anë të Urdhërit nr. 826, datë 23.04.2012, ka ngritur Grupin e Punës “Për hartimin e projekt akteve për miratim në Këshillin e Ministrave lidhur me pagesat që kryhen në AKEP”;
2. Pagesat që kryhen në AKEP për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike në zbatim të Rregullores nr. 20, “Mbi pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike”, së bashku me pagesat për caktimin dhe përdorimin e frekuencave dhe të numrave e serive numerike, përbëjnë paketën e akteve nënligjore mbi pagesat që kryhen në AKEP, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së AKEP, si organ rregullator në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008;
3. AKEP, duke u nisur nga eksperiencia e dy viteve të fundit, mbi menaxhimin e spektrit të frekuencave, të cilën e karakterizon dinamika e lartë e ndryshimeve dhe inovacionit të teknologjisë së komunikimeve elektronike, vlerëson se përcaktimet e VKM nr. 599, duhen ndryshuar me qëllim që, të nxisin një mjedis më të favorshëm, jo diskriminues me synimin e përafrimit me raportet e vendeve të Rajonit dhe të BE;
4. Për këto arsye, AKEP propozon rishikimin e pagesave për përdorimin e frekuencave radio dhe për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike, sipas dokumentit për Këshillim Publik, bashkëlidhur;

5. Dokumenti për Këshillim Publik, është hartuar duke marrë si referencë kryesore:
- Eksperiencën dhe çështje të hasura gjatë implementimit të VKM nr. 599, datë 23.07.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike” dhe,
  - Modele të disa vendeve të rajonit dhe BE.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e nxjerrjes së këtij dokumenti, si për AKEP ashtu dhe për sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike,

### **V E N D O S:**

1. Të miratojë për Këshillim Publik dokumentin: “Mbi propozimin për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike””, bashkëlidhur;
2. Periudha e Këshillimit Publik do të jetë 30 dite nga data e publikimit të dokumentit në Internet në faqen zyrtare të AKEP;
3. Ngarkohet Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin Nr. 826, datë 23.04.2012, për administrimin e procesit të Këshillimit Publik;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al);

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tij;

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

### **ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**

# PËRMBAJTJA

## PARATHËNIE

1. HYRJE .....	2
2. PAGESAT AKTUALE PER PERDORIMIN E FREKUENCAVE.....	4
3. PROPOZIMET E PAGESAVE PER SPEKTRIN E FREKUENCAVE PER SHERBIMET RADIO .....	4
3.1 Sherbimi telefonik publik i levizshem tokesor.....	4
3.2 Sherbimi privat i levizshem radio – PMR .....	6
3.3 Lidhjet fikse radio .....	6
3.4 Sherbimet Satelitore .....	8
3.5 Pagesa të tjera .....	8
4. PAGESAT PER CAKTIMIN DHE PERDORIMIN E NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE .....	10
5. PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJE PËR KONSULTIM .....	12

## 1. HYRJE

AKEP, në bazë të germës a) pika 3 e nenit 62 të Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*”, është autoriteti rregullator kombëtar, përgjegjës për të administruar spektrin e frekuencave të caktuara për qellime civile, përveç frekuencave të caktuara për transmetimet radio dhe televizive.

Sipas Ligjit nr. 9918 dhe legjislacionit të BE, AKEP duhet të caktojë pagesa, të cilat duhet të sigurojnë përdorimin optimal të spektrit të radios. Këto pagesa duhet të jenë objektivist të justifikuara, jo-diskriminuese, proporcionale, të nxisin konkurrencën, përdorimin efikas dhe sigurimin e menaxhimit efektiv të frekuencave radio.

Në lidhje me pagesat që kryhen në AKEP gjërat c) dhe ç) të nenit 119 të ligjit nr. 9918 përcaktojnë se sipërmarresit, duhet të kryejnë pagesat në AKEP për:

- a) Caktimin dhe përdorimin e frekuencave, dhe
- b) Caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike.

Pagesat që kryhen në AKEP për caktimin dhe përdorim e frekuencave, për shërbimet e ndryshme radio, janë përcaktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 599, datë 23.07.2010 të (VKM Nr.599) “*Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike*”.

AKEP, nisur nga eksperiencia e deri tanishme mbi menaxhimin e spektrit të frekuencave, dinamika e lartë e ndryshimeve dhe inovacionit të teknologjisë së komunikimeve elektronike, vlerëson se përcaktimet e VKM nr.599, duhen ndryshuar me qëllim që, të nxisin një mjedis më të favorshëm, jo diskriminues me synimin e përafrimit me raportet e vendeve të Rajonit dhe të BE.

Për këto arsye, AKEP ka menduar rishikimin e pagesave për përdorimin e frekuencave radio për:

- Shërbimin telefonik publik i lëvizshëm tokësor;
- Shërbimin privat i lëvizshëm radio-PMR;
- Shërbimin fiks radio;
- Shërbimet satelitore;
- Shërbime të tjera radio, si dhe;
- Përcaktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike.

AKEP në zbatim të Lligjit Nr. 9918 dhe në përputhje me Udhëzuesin e Procedurave për Këshillimin me Publikun miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, Nr. 1183, datë 10.03.2010, në kuadër të transparencës dhe paanësisë nxjerr për Këshillim Publik këtë dokument me propozim për disa ndryshime në VKM nr. 599, datë 23.07.2010.

Qëllimi i këtij dokumenti është të rishikojë pagesat e tanishme, të aplikuara për shërbime të caktuara radio dhe të kërkojë mendime dhe komente mbi ndryshimet e propozuara, të cilat ndikojnë në përdorimit dhe menaxhim efektiv të spektrit të frekuencave radio, inkurajojnë shfrytëzimin e mëtejshëm të spektrit radio nga sipërmarrësit ose operatorë të rrjetit të komunikimeve elektronike publike e private dhe përdoruesit e tjerë të pajisjeve-radio.

### **Dërgimi i Komenteve**

Të gjitha komentet janë të mirëpritura, do të vlerësonim që çdo koment/përgjigje t'i referohet pyetjes me numrin përkatës që ka ky dokument konsultimi.

Periodha e konsultimit do të zhvillohet nga data \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2012 deri më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2012.

Gjatë kësaj periudhe AKEP mirëpret komentet me shkrim për çdo çështje të ngritur në këtë dokument.

AKEP, gjatë periudhës të këshillimit publik do të zbatojë procedurat dhe kërkesat përkatëse në përputhje me Udhëzuesin e Procedurave për Këshillimin me Publikun miratuar me Vendim nr. 1183, datë 10.03.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP dhe do të zbatojë kërkesat për ruajtjen e kofidencialitetit të të dhënave që do të paraqesin palët e interesuara.

## 2. PAGESAT AKTUALE PER PERDORIMIN E FREKUENCAVE.

Pagesat aktuale, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike bëhen sipas VKM Nr.599, datë 23.07.2010. Këto pagesa janë bazuar përgjithësisht në veçoritë e brezave të frekuencave dhe të shërbimeve përkatëse radio si dhe në raste të veçanta për paisjet radio për disa kategori shërbimi siç janë ai detar edhe aereonautik.

Përmbajtja e plotë VKM Nr.599, date 23.07.2010 mund të gjendet në faqen elektronike të AKEP në linkun: <http://akep.al/images/stories/AKEP/legjislacioni/dokumentet-pagesave/vkm-nr-599-dat-23-7-2010.pdf>.

AKEP në vijim ju paraqet propozimet për ndryshimet në pagesat për përdorimin e frekuencave duke i krahasuar me ato që janë në përdorim deri tani.

## 3. PROPOZIMET E PAGESAVE PER SPEKTRIN E FREKUENCAVE PER SHERBIMET RADIO

### 3.1. Shërbimi telefonik publik i lëvizshëm tokësor

VKM Nr. 599, datë 23.07.2010, në Pikën 2.1 “Shërbimi telefonik publik i lëvizshëm tokësor”, përcakton se, “Pagesat vjetore për përdorimin e frekuencave radio për shërbimin telefonik publik të lëvizshëm tokësor (GSM, UMTS 900/1800 MHz dhe UMTS (1900-1980) dhe (2010-2170) MHz, do të llogariten sipas të dhënave të tabelës nr. 1”, e cila është në vijim:

***Tabela nr. 1***

Brezi i Frekuencave	Njësia e matjes së brezit	Pagesat Vjetore në Lek
(880-915)/(925-960)	Kanal (2*200) kHz	100,000
(1710-1785)/(1805-1880)	Kanal (2*200) kHz	100,000
(1920-1980)/(2110-2170)	Brez (2*5) MHz	2,000,000
(1900-1920)MHz dhe (2020-2025)	Brez (1*5) MHz	1,000,000

AKEP, në zbatim të parimit të neutralitetit teknologjik dhe shërbimeve radio, si dhe alokimin e brezave të rinj për shërbimet e reja, mendon të mos përfshihen përcaktimet për shërbimet radio: GSM, UMTS, etj., por të jenë vetëm ndarja në brezat e frekuencave,

## **AKEP PROPOZON,**

Ndryshimin e Pikës 2.1 të VKM Nr 599, datë 23.07.2010, dhe Tabela Nr.1, si vijon:

### **2.1. Shërbimi telefonik publik**

Pagesat vjetore për përdorimin e frekuencave radio për shërbimin publik, të llogariten sipas të dhënave të Tabeles Nr.1.

**Tabela Nr.1**

<b>Nr.</b>	<b>Brezat e frekuencave [MHz]</b>	<b>Njesia e matjes së brezit</b>	<b>Pagesae vjetore në leke</b>
1	(450-470)	(2*5) MHz	2.500,000
2	(790-880)	(2*5) MHz	2.300.000
3	(880-915) / (925-960)	(2*200) kHz	70,000
4	(1710-1785) / (1805-1880)	(2*200) kHz	70,000
5	(1920-1980) / (2110-2170)	(2*5) MHz	1,400,000
6	(1900-1920); (2010-2025)	(1*5) MHz	700,000
7	(2500-2570 ) / (2620-2690)	(2*5) MHz	1,200,000
8	(2570-2620)	(1*5) MHz	600,000
9	(3400-3600) / (3600-3800)	(2*5) MHz	1,000,000



### Pyetje Nr. 1

*Cili është mendimi Juaj në lidhje me propozimet për uljen e pagesave për brezat e frekuencave radio që janë në përdorim (Nr. rendor 3 deri 6 )?*

### Pyetja Nr.2

*Cili është qendrimi juaj për pagesat e propozuara për brezat e frekuencave që përfshihen rishtas (Nr. Rendor 1, 2 dhe 7 deri 9)?*

## **3.2. Shërbimi privat i lëvizshëm Radio-PMR**

Me qëllim rritjen e efektivitetit të përdorimit të brezave VHF dhe UHF të frekuencave, nuk do të përdoren në të ardhmen sisteme radio PMR me zona të mbulimit me shërbim mbi 50 km.

## **AKEP PROPOZON,**

### **Shfuqizimin e Kategorisë 5,**

*“Sistemi PMR në zonë shërbimi kombëtar për zonën e ofrimit të shërbimit më të madhe se 50 km, pagesa për çdo sistem është 100 000 lek”,*

te Tabela Nr.2, të VKM Nr 599, datë 23.07.2010.

### Pyetje Nr. 3

*Cili është mendimi juaj për këtë propozim, shfuqizimin e Kategorisë nr. 5, në Tabelën Nr.2 të VKM nr.599, dhe a keni mendim për ndryshime të tjera?*

## **3.3 Shërbimi fiks radio**

Pagesa vjetore për lidhjet fikse radio aktualisht llogariten sipas Tabelës Nr. 3 të VKM Nr. 599, datë 23.07.2010:

**Tabela nr. 3**

*Në lekë*

Brezi frekuencave	Gjerësi kanali ( BW)			
	Bw≤ 3.5 MHz	3.5< Bw≤20MHz	20< Bw≤40MHz	BW >40MHz
$f \leq 1$ GHz	50.000	--	--	--
1GHz < $f \leq 14$ GHz	60.000	78.000	90.000	120.000
14 GHz < $f \leq 20$ GHz	55.000	70.000	80.000	100.000
20 GHz < $f \leq 37$ GHz	45.000	60.000	70.000	80.000
37 GHz < $f \leq 39.5$ GHz	35.000	45.000	55.000	65.000
$f > 39.5$ GHz	10.000	13.000	15.000	20.000

AKEP mendon të ruhet e njëta tabelë për ndarjen e brezave të frekuencave dhe gjerësitë e kanaleve radio, dhe

**AKEP PROPOZON**

Ndryshimin e Tabelës Nr.3 të VKM Nr. 599, datë 23.07.2010, si vijon:

**Tabela Nr.3**

*Në lekë*

Brezi frekuencave	Gjerësi kanali ( BW)			
	Bw≤ 3.5 MHz	3.5< Bw≤20MHz	20< Bw≤40MHz	BW >40MHz
$f \leq 1$ GHz	30.000	--	--	--
1GHz < $f \leq 14$ GHz	40.000	50.000	55.000	75.000
14 GHz < $f \leq 20$ GHz	35.000	45.000	50.000	65.000
20 GHz < $f \leq 37$ GHz	28.000	35.000	45.000	50.000
37 GHz < $f \leq 39.5$ GHz	20.000	30.000	35.000	45.000
$f > 39.5$ GHz	8.000	10.000	12.000	15.000

**Pyetja Nr. 4**

***A jeni dakort të ruhet e njëjta strukturë e tabelës së mësipërme lidhur me ndarjen e brezave të frekuencave radio?***

## Pyetja Nr. 5

*Cili është mendimi Juaj për vlerat e pagesave të propozuara?*

### 3.4 Shërbimet satelitore

Pagesat vjetore për përdorimin e frekuencave për shërbimet satelitore, kur frekuencat e punës janë pjesë e brezave të përdorimit ekskluziv satelitor, llogariten sipas Tabelës Nr. 6, të VKM Nr. 599, datë 23.07.2010:

**Tabela nr. 6**

Brezi i frekuencave	Fuqia EIPR dBW	Numri i pajisjeve	Pagesa vjetore në Lek
(12,5-12,75) GHz ose (14,0-14,25) GHz	<50		Nuk aplikohet pagesë
	>50	Deri në 10 SES	20,000
		Për çdo SES shtesë mbi numrin 10	Do të shtohet pagesa 3000 lek

AKEP, bazuar në Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave, mendon të përfshijë në brezat e mësipërm të frekuencave dhe pjesën e brezit (14.25 deri 14.50) GHz, që përdoret për MSS, FSS, VSAT/SNG, me prioritet për rrjetet civile, prandaj,

### **AKEP PROPOZON**

Që tabela e mësipërme të ndryshoje si vijon:

**Tabela Nr.6**

Brezi i frekuencave Up link (Toke-Hapsire)	Fuqia EIRP dBW	Numri i pajisjeve	Pagesa vjetore /leke
12.5-12.75 GHz Ose 14.0-14.50 GHz	< 50	Nuk aplikohet pagesë	
	>50	Deri në 10 SES	20,000
		Për çdo SES shtesë mbi numrin 10	Do të shtohet pagesa 3000 leke

**Pyetja nr.6**

***Cili është mendimi juaj për këtë ndryshim të propozuar tek Tabela Nr. 6 të VKM nr.599?***

**3.5 PAGESA për shërbime të tjera radio, leje dhe autorizime**

Pika 4.2 e tabelës nr. 9 e VKM Nr. 599, aktualisht përcakton se:

*“Pagesa vjetore për certifikatë konformiteti pajisjesh për subjektet jotregtare vendase është 1000,00 leke vetëm njëherë”*

**AKEP PROPOZON,**

Pika 4.2 e Tabelës nr. 9 e VKM Nr. 599, date 23.07.2010, të shfuqizohet.

**Pyetja nr.7**

***Cili është mendimi juaj për këtë ndryshim tek Tabela Nr. 9, e VKM Nr. 599?***

**Pyetja nr.8**

***A mendoni se duhen bërë ndryshime të tjera për pagesat që përmban Tab. Nr.9, e VKM Nr.599?***

**4. PAGESA PËR PËRCAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE.**

VKM Nr. 599, date 23.07.2010, përcakton se llogaritja e pagesave për caktimin dhe përdorimin e numrave bëhet sipas Tabela Nr. 10.

AKEP, bazuar në krahasimin e pagesave vjetore për përdorimin e numrave dhe serive numerike (për disa nga rregullatorët e rajonit) si dhe nga eksperiencia e dy viteve të fundit, mendon të realizojë ndryshimet si më poshtë vijon:

- a. Numra jo-gjeografikë për: (nga 25.000Lek në 20.000Lek)
- Shërbimin Free-Phone (800)-numër jeshil,
  - Shërbimin me Ndarje të Kostos (808)-numër blu.

- b. Numra jo-gjeografikë për: (nga 25.000Lek në 20.000Lek)
- Shërbimi Data Network, Internet, (717),
  - Rrjeta për Qëllime Specifike (711),
  - Shërbimi Posta Zanore (712),
  - Rrjeta Virtuale Private (713).
- c. Kodi i Aksesit për bartësin, (nga 40.000Lek në 100.000Lek)
- Formati: 10XX (ku X=0 ÷ 9)
- ç. Kodi i Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit-ISPC (nga 50.000Lek në 100.000Lek)
- d. Kodi i Rrjetit Mobile-MCC/MNC (nga 50.000Lek në 100.000Lek)
- e. Kodi i Ident. të Rrjetit Transmetim të Dhënash-DNIC (nga 50.000Lek në 100.000Lek)

Për sa më sipër,

## **AKEP PROPOZON,**

Që Tabela Nr. 10 e VKM Nr. 599, datë 23.07.2010 të ndryshojë si më poshtë vijon:

**Tabela Nr. 10**

(Në Lekë)

Nr.	Emërtesa	Pagesa për caktimin e numrave dhe serive numerike	Pagesa vjetore për përdorimin e numrave dhe serive numerike
1	Numra gjeografikë: Blok 1 000 numrash Blok 10 000 numrash	1.000 1.000	1.000 4.000
2	Numra jo-gjeografikë për: -Shërbimin e Komunikimeve Publike të Lëvizëshme, -Shërbimin Paging (63), -Shërbimin e Komunikimeve Personale (700), Blok 1 000 numrash Blok 10 000 numrash	1.000 1.000	2.000 5.000
3	Numra jo-gjeografikë për: -Shërbimin Free-Phone (800)-numër jeshil, -Shërbimin me Ndarje të Kostos (808)-numër blu.	1.000	20.000

4	Numra jo-gjeografikë për: -Shërbimi Data Network, Internet, (717), -Rrjeta për Qëllime Specifike (711), -Shërbimi Posta Zanore (712), -Rrjeta Virtuale Private (713).	1.000	20.000
5	Numra jo-gjeografikë për: -Shërbimi me Ndarje të Ardhurash (900), -Shërbimi i Kartës së Parapaguar (801).	1.000	25.000
6	Numër i Shkurtër për: -Shërbimin SMS/MMS me vlerë të shtuar (VAS), Formati: 5XXXX (ku X=0 ÷ 9): numër individual bllok 10 numrash	1.000 2.000	20.000 100.000
7	Kode të Shkurtër të Harmonizuar në nivel European(HESC), Formati: 11X dhe 19X (ku X=0 ÷ 9)	1.000	Pa pagese
8	Kodi i Shkurtër i urgjencës, Formati: 12X (ku X=5 ÷ 9)	1.000	Pa pagese
9	Kodi i Aksesit për bartësin, Formati: 10XX (ku X=0 ÷ 9)	2.000	100.000
10	Kodi i rrugëzimit për Portabilitetin e Numrit, Formati: 99XX (ku X=0 ÷ 9)	1.000	20.000
11	Kodi i Pikës Kombëtare të Sinjalizimit-NSPC	1.000	20.000
12	Kodi i Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit-ISPC	2.000	100.000
13	Kodi i Rrjetit Mobile-MCC/MNC	2.000	100.000
14	Kodi i Identifikimi të Rrjetit Transmetim të Dhënash-DNIC	2.000	100.000

### **Pyetje nr. 9**

*Cili është qëndrimi juaj mbi këto propozime dhe a mendoni se duhet të bëhen ndryshime të tjera?*

## **5. PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJEVE PËR KONSULTIM:**

### **3.1. Shërbimi telefonik publik i lëvizshëm tokësor**

#### **Pyetje Nr. 1**

*Cili është mendimi Juaj në lidhje me propozimet për zvogelimin e pagesave për brezat e frekuencave radio që janë në përdorim ( Nr. rendor 3 deri 6 )?*

#### **Pyetja Nr.2**

*Cili është qendrimi juaj për pagesat e propozuara për brezat e frekuencave që përfshihen rishitas ( Nr. Rendor 1, 2 dhe 7 deri 9)?*

### **3.2. Shërbimi privat i lëvizshëm Radio-PMR**

#### **Pyetje Nr. 3**

*Cili është mendimi juaj për këtë propozim, shfuqizimin e Kategorisë nr. 5, në Tabelën Nr.2 të VKM Nr. 599, dhe a keni mendim për ndryshime të tjera?*

### **3.3. Shërbimi fiks radio**

#### **Pyetja Nr. 4**

*Jeni dakort të ruhet e njëjta strukturë e tabelës së mësipërme lidhur me brezat?*

#### **Pyetja Nr. 5**

*Cili është mendimi Juaj për vlerat e pagesave të propozuara?*

### **3.4. Shërbimet satelitore**

#### **Pyetja nr.6**

*Cili është mendimi juaj për këtë ndryshim të propozuar në Tabela Nr. 6 të VKM Nr.599?*

### **3.5 Pagesa për shërbime të tjera radio, leje dhe autorizime.**

#### **Pyetja nr.7**

*Cili është mendimi juaj për këtë ndryshim tek Tabela Nr.9 e VKM Nr. 599?*

#### **Pyetja nr.8**

*A mendoni se duhen bërë ndryshime të tjera për pagesat që përmban Tab. Nr.9 e VKM Nr. 599?*

**4. PAGESA PËR PËRCAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E NUMRAVE DHE  
SERIVE NUMERIKE.**

**Pyetje nr. 9**

*Cili është qendrimi juaj mbi këto propozime dhe a mendoni se duhet të bëhen ndryshime të tjera?*